Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Vertetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- 1. Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles nuk duhet të jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te prokuruar.
- 2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2017, 2018 dhe 2019 .
- 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- 4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2019 (Sipas QKB) sipas percaktimeve në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2019.

2.3 Për kapacitetin teknik:

- 1. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të prokuruar, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit;

Si deshmi për pervojën e meparshme kerkohen:

- i. Kontrata të ngjashme për furnizime me entin që ka realizuar këto lloj furnizimi e shoqëruar me vertetimin e realizimit me sukses nga autoriteti kontraktor

- ii. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat sasitë e mallrave të furnizuara.
2. Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme si më poshtë:
 1. Çertifikate **ISO 9001:2015 "Per menaxhimin e cilesise"**objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit,e vlefshme
 2. Çertifikate **ISO 22000:2018 "Per sistemin e menaxhimit te sigurise ushqimore"**objekt i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit e vlefshme
3. Operatori duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
4. Operatoret ekonomik duhet të jenë të pajisur me licenca nga QKB kodi II.I.B"Shitje me shumice e ushqimeve me origjinë shtazore".
5. Operatoret ekonomik duhet të kenë në pronesi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare mishi e përshtatshme për tregtimin e mishit dhe nënprodukteve të tij objekt prokurimi e pajisur me Leje Higjenosanitare me dhomë frigoriferike ose nëse është me qera duhet të paraqesin kontratën e qirase e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të figurojë i rregjistruar në QKB si aktivitet.
6. Operatoret ekonomik duhet të kenë në pronesi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objektin Furre Buke e pajisur me Leje Higjenosanitare dhe licence Kodi II 1 A dhe leje mjedisore nga QKB kodi III 1 A ose nëse është me qera duhet të paraqesin kontratën e qirase e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të figurojë i rregjistruar në QKB si aktivitet të shoqëruar me licencat e mesipërme.
7. Operatoret ekonomik duhet të kenë në pronesi për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare ushqimore e pajisur me Leje Higjenosanitare ose nëse është me qera duhet të paraqesin kontratën e qirase e vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të figurojë i rregjistruar në QKB si aktivitet.
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Flete-analiza të artikujve ushqimor që prokurohen (nr.1,2,3,4,5,6,9,10,)nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës ku të përshihen të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.
9. Subjekti ofertues duhet të jetë i pajisur me leje higjeno-sanitare për objektin ku ushtron aktivitetin.
10. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore
11. Operatoret ekonomik pjesëmarrës në tender e mesipërme disponojnë 1 (një) automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportimin e mallrave dhe 1 (një) automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportimin e mallrave objekt prokurimi dhe

zbatimin e kontrates.Mjetet duhet te jene te pajisur me (leje qarkullimi)akt kolaudimi,policen e sigurmit te mjetit

12. Diten e hapjes se tenderit Operatoret ekonomik ofertues te bejne paraqitjen e mostrave per produktet me nr.rendor **(nr.1,2,3,4,5,6,9,10,).**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

BUKË MASIVE

Bazuar në STASH 1411\87

Treguesit shqisor

Korja : e lemuar, pa flluska, pa carje e pjese të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njellojtë mjalti në të kuqerremt

Tuli: masë e njellojtë e pjekur mirë ,jo e ngjitshme me pofre të shpërndara në menyrë të njetrajtshme dhe pa gjurme mielli të pa brumosur.Kosinsisenca elastike me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë , jo i thermueshem dhe pa shtresa .

Era dhe shija : e këndshme e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur .

Forma :e rregullt pa shtypje e deformime.

Treguesit fiziko – kimik:

- ❖ Lageshtira në % jo me shume së 45
- ❖ Poroziteti në % jo me pak se 70
- ❖ Aciditeti në grad jo me shume se 4.5

Buka dërgohet për konsum jo me parë se 3 orë nga koha e pjekjes .Masa e caktuar sipas llojit të bukës ti përgjigjet masës 3-4 orë mbas pjekjes

Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e paketuar secila në qese letrë

Marrja në dorëzim i mallit do të behet mbi bazen e peshes dhe jo me copë

Transporti duhet të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorëve të tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno sanitare për transportin e produkteve ushqimore

Operatori furnizues duhet të paraqese fletë analizat nga AKU sa herë që I kërkohen nga pritësi I mallit

BLERJE USHOIME TË NDRYSHME

Operatori furnizues duhet të paraqesë fletë analizat nga AKU sa herë që I kërkohen nga pritësi I mallit

MAKARONA, STASH 1170 - 87

Lloji: Makarona të thjeshta spageti ose forma të tjera sipas porosisë së blerësit

Pamja : Të jenë me forme të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lemuar deri lehtësisht të ashpra, lejohen deformime të vogla, mbas zierjes të jenë elastike,të mos qullosten, të mos cahen e të mos krijojnë shkume.

-**Ngjyra:** E bardhe me nuance të verdhe në thyerje paraqitën qelqore në jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

-**Era dhe shija:** E mirë karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe cfardo erë dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko-kimik : Lageshtira deri në 13 %, aciditeti jo me shume se 0.16 %, rritja e volumit jo me pak se dy herë. Nuk lejohen demtues. Mielli i stazhionuar jo me pak se 15 ditë, i situr 100%, nuk lejohen demtues.

Amballazhimi: Makaronat të jenë të ambalazuara në qeska polietileni me mase 0.5 kg , të paketuara në kuti kartoni.Shenimet duhet të jenë të qarta e lehtësisht të lexueshme.Emri prodhuesit duhet të jetë I dallueshem, me tregues të qartë dhe afate garancie . Duhet të këtë etiketë shtese në gjuhen shqip.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

SHEQER, STASH 1413- 87

Pamja: Pluhur i pastër i përberë nga kristale të imta dhe të njellojta, pa copa sheqeri të ngjeshura ose lendë të huaja. Të jetë i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.

Ngjyra: E bardhe dhe me shkëlqim. Shije të embel ,pa shije dhe erë të huaj.

Tretshmeria: Tretet plotsisht në uje, tretësia është e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Lageshtia , jo me shume se 0.16%

Amballazhimi : Sheqeri të jetë i ambalazhuar nëpako 1 kg me peshe standart ..Etiketa duhet të jetë e fiksuar.Shenimet duhet të jenë të qarta e të lexueshme ku të jetë shenuar afatet e garancisë , emir I prodhuesit. Duhet të ketë etiket shtesë në gjuhen shqipe.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

KRIPË USHQIMORE

STAZH:

1437\01.07.1995

Treguesit cilësorë:

I. Ngjyra:

E bardhë

2. Era dhe shija:

E kripur pa shije dhe erë të huaja.

3. Pamja e jashtme: Masë kokrrizore Treguesit fiziko kimik:

1-Imtësia në mm 0.2 – 2 .

2-Klorur Na në lëndën e thatë në %, jo më pak se 98.

3- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

4-Sulfat Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9.

5-Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2.

6-Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

7-Lagështirë në %, jo më shumë se 1.

8-Jodur kaliumi mg/kg 50 (+ /-)3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetsisë.

Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha nëto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes

së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi:

- Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimore, me masë 0.5 KG. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.
- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionët e detyrueshme duhet të

figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja nëto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjinë dhe raport analize të laboratorit

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

Oriz,

STASH: 1738 – 87. zv. 1738-84,1451-85

Pamja: Të jenë kokrra të pastra, të zhveshura tëresisht nga levozhga e orizit, pa shenja myku ose prishje.

-**Ngjyra:** E bardhe ,

-**Era dhe shija :** Karakteristike e Orizit të shendoshe, pa shije të thartë , të hidhur, pa erë myku dhe cfardo erë tjetër të huaj.

Lageshtia jo me shume se 15%

Lendë të huaja, jo me shume 0.2

Kokrra të thyer jo me shume se 8%

Nuk lejohen demtues hambari, lendë minërale, kokrra të pazhvilluara, ose të mykura.

Amballazhimi : Orizi të jetë i ambalazhuar në pako standarte me peshe 1 kg .Etiketa e produktit duhet të fiksohet që të mos shpëputet ku të jenë shkruar proluuesi dhe afatet e skadences.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

VAJ USHQIMOR:

STASH 203 –2002

Lloji: Vaj ushqimor luledielli i rafinuar

Pamja : Leng vajor i qartë pa depozitime.

Ngjyra: E verdhe e lehtë.

Era dhe shija: Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj .

Treguesit Fiziko - Kimik:

Aciditeti si acid oleik 0.2 gr në 100 gr/ Vaj

Lendë të pasapunifikueshme jo me shume se 15 g/ kg

Amballazhimi: Vaji të jetë i ambalazhuar në shishe plastike me vellim 1litër me tapë plastike me vidhezim të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse, të sistemuara në kuti kartoni.

Etiketa duhet të jetë e fiksuar të shkruara qartë proluuesi dhe afati I përdorimit

Duhet të ketë etiketë shtesë në gjuhen shqipe.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

MIELL

Të jetë i pastër i cilesisë së parë (00) i stazhionuar rreze 75 , pa sheja të mykut e po të tjera të kësaj natyrë, I bardhe .I paketuar në pako 1 kg me etiketën e prodhuesit dhe afatet e garancisë dhe të futura në kuti kartoni.

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Afati skadences do të jetë jo me pak se 1 vit pas ditës se furnizimit.

Transporti do të behet me mjetë të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

RECEL

Treguesit cilësorë të recelit:

Pamja e jashtme: Jo e shëndritshme, e pasheqërosur, me sipërfaqe të njëllojtë, ku shënja myku dhe fermentimi nuk lejohen, pa pjesë të djegur, fletë fruit, fara dhe pjesë të fermentuara.

Ngjyra: E njëllojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.

Shija dhe era: Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamelizimi e fermentimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Të jetë në kavanoza qelqi 0.7kg me etiketë, ku të tregohet

-Emërtimi i plotë i mallit.

-Data e skadimit.

Afati skadences do të jetë jo me pak se dy muaj pas ditës se furnizimit.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

BULMETRA

Operatori furnizues duhet të paraqesë fletë analizat nga AKU sa herë që I kërkohen nga pritësi I mallit

DJATHE I BARDHE:

Bazuar në STAZH....1410 \87

Treguesit shqisorë:

1.Forma:

Prizëm, trekëndësh me faqe anësore cilindrike.

2.Pamja e jashtme dhe e brendshme:

E formuar mirë, e pastër e pa njolla, pa lëndë të huaja. Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe.

Në prerje është e njëllajtë, e pastër, pa lëndë të huaja, me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.

3.Struktura:

E lëmuar, e butë pa dallim shtresash.

4.Shija dhe era:

E kënaqëshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur e djegëse dhe pa shije dhe erë të huaj

Treguesit fiziko-kimik

1-Lagështira në %,jo më shumë se:

Për periudhën 1 Prill- 30 Qershor, 52

Për periudhën 15 Shtator- 31.Mars, - 56

2- Lëndët e thata në %, jo më pak se:

Për periudhën 1 Prill- 30 Qershor - 48

Për periudhën 15 Shtator- 31.Mars - 44

3-Yndyra në lëndët e thata në %, jo më pak se 50

4-Kripë në % deri 4 +/- 1

5-Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Amballazhimi:

Në voza plastike me vëllim 20-30 litër.

Djathi në voze qëndron i mbuluar me shëllirën fillestare, e cila përmban 10 – 14 % kripë deti.

Mbi çdo ambalazh me djathë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha nëto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionët e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja nëto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë. N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale. Malli të shoqërohet me çertifikatë cilësie të lëshuar nga institucionë të licënuara dhe raport analiza të laboratorit.

Ruajtja: Djathi i bardhë duhet të ruhet në frigorifer në temperaturë 3- 5 gradë

dhe lagështi relative të ajrit rreth 95%. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 12 muaj.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore

PRODUKTE MISHI

Operatori furnizues duhet të paraqesë fletë analizat nga AKU sa herë që I kërkohen nga pritësi I mallit

SALLAM

Me perberje vici ,i paketuar ne pako treshe celefone, nga 250 gr secila I fresket dhe i paisur me certifikate nga AKU-ja, te mos permbaje shume yndyre dhe te sillet, me mjete frigoriferike. Mishi te jete ngjyre roze dhe te kete ere te kendeshme. Malli te jete i shoqeruar me çertifikate cilesie me te gjithë parametrat.

FASULE

STASH 1743 - 87

Treguesit shqisore: Pamja të jetë kokrra të shendosha e të plota, jo të therrmuara, të bardha, pa erë myku, lageshtia deri në 15%, thyeshmeria deri në 13 %, lendë të huaja deri në 0.8%, demtime nga insekticidet nuk lejohen

Ambalazhimi: Fasulet të jenë të ambalazhuara në qese të pastër, të thatë, të dizinfektuar dhe pa erë të huaj. Fasulet duhet të jenë të ambalazhuara në pako 1 kg. Etiketa duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi. Shenimet duhet të jenë të dukshme dhe lehtësisht të

lexueshme. Emri i produktit duhet të bjerë në sy në pamje të parë. Të jetë etiketuar afati garancisë me afat jo me shuma se dy muaj nga magazinimi.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimor

MOLLE ,PORTOKALLE, BABANE

STASH 1752 . 88

Lloji: Molle Cilsia e parë

Treguesit shqisore: Të freskëta me zhvillim normal, të shendosha, me forme ngjyrë e shije të kultivarit pa deformime, pa erë e shije të huaj.

Madhesia e Kokres: E prerë gjerazi jo me pak se 60 m/m

Nuk Lejohen: Demtime mekanike, të prekura nga sëmundjet, të kalbura,të ngrira, njolla kalbezimi, demtimet e sipërme, gunga, krimba në brendësi

Amballazhimi: Të jenë të ambalazhuara me arka kartoni ose kaucuku

Verifikimi Cilsor : Do të behet nëpërmjet kontrollit organo leptik .

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimor

Amballazhimi me qese, pesha sipas kerkesave te Entit.

ZARZAVATE DHE PERIME

Zarzavate te jene sipas stines duke perfshire te gjitha llojet si: Domate, specia, patllixhana, presh ,laker, etj. -Amballazhimi me qese, pesha sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

KARROTA

Treguesit cilësorë të karrotës: 1. Pamja e jashtme:Të freskët me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta. 2. Përbërja e brendshme e tulit: Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm. 3. Madhësitë: Gjerësia (diametrik me i madh)deri në 4 cm, Gjatësia 10 -15 cm. Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në % jo më shumë se 2. 4. Të prekura nga sëmundjet, insektet e të kalbura: Nuk lejohen. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88. Transporti i perimeve të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore

SALCE DOMATE

Bazuar në STAZH 1429\87

Lloji: Salce domate sheshe

Treguesit shqisore :masë e njellojtë me kosistence pastë, jo fibroze pa fara pa copa lekurë pa pjesë të karamelizuara të prishura ose të fermentura. .Ngjyra : E kuqe intensive karakteristike e salces së domates e njellojtë në të gjithë masën

Era dhe shija :Karakteristikë e domates pa shije dhe erë të huaj pa shije karamelizimi prishje ose fermetimi .

Aciditeti i përgjithshem në raport me ekstraktin i shprehur në acid acetic në% jo me shume se 0.1.

Ngarkesa mikrobikë. Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e Shendetsisë.

Në salcen e domates nuk lejohen përmbajtje e lëndëve të huaja dhe përdoruesi i ngjuresve artificial .

Ambalazhohet nëme shishe qelqi 700 gr Mbi cdo ambalazh vendoset etiketa e cila duhet të përmbaje të dhenat llojin e prodhimit,afatet e përdorimit dhe prodhuesit

Nuk lejohet me afat skadence me shume se 1 vit nga data e furnizimit

Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë të cilesisë dhe të standarteve të miratuara .Në etikete të jetë shenuar data e prodhimit , data e skadences.

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimor

QEPË E THATË

STASH 1755\88

Kërkohet cilesia e parë,të jetë me pjekuri të plotë,me cipë e bisht të thatë,të shendosha e të plota,me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Madhesia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4-8 cm dhe për llojet e tjera 5-10 cm.

Lejohen jo me shume se 1 % e partisë me demtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.

Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Ambalazhimi në thasë në masën 20 -30 kg

Transporti do të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimor

V.O. Për produktet ushqimore të freskëta të fruta – perime të pa përpunuara.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Nr	Lloji I mallit	Njësia	Sasia	cmimi	Vlera
1	Bukë masive	kg	6590		
2	Makarone	kg	1110		
3	Miell	kg	1110		
4	Oriz	kg	1110		
5	Sheqer	kg	1480		
6	Vaj gatimi	Lit	1110		
7	Recel kavanoze	kg	740		
8	Kripë	kg	60		
9	Djath i bardhë	kg	160		
10	Salam	kg	135		
11	Fasule	kg	1110		
12	Karrota	kg	100		
13	Zarzavate	kg	150		
14	Qepë	kg	680		
15	Banane	kg	500		
16	Salcë 700g	copë	125		
	Shuma				
	TVSH 20 %				
	Vlera totale				

- Levrimi I mallit do te behet nga nenshkrimi i kontrates deri me 31.12.2020.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.

- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
